

RELACION

Mbi Ecurine Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 3-mujorin e trete të vitit 2012

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të Ligjit nr. Nr. 10 487, dhe datë 5.12.2011 "Per buxhetin e shtetit për vitin 2012", Udhezimit nr. 2 datë 6.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetin" dhe Udhezimit nr.2/1 datë 15.02.2012 "Per zbatimin e buxhetin e shtetit për vitin 2012", i është akorduar një fond i planifikuar prej **94 milione e 792 mijë lekë.**

Ne fillim te vitit 2012, Detajimi I Buxhetit te vitit 2012 ishte si me poshte vijon:

Tabela e Detajimit te Buxhetit te vitit 2012 (ne leke)

Fondi I Pagave (zeri 600)	11,089,000
Fondi I Sigurimeve Shoqerore (zeri 601)	1,703,000
Fondi per shpenzimet operative (zeri 602)	7,000,000
Fondi per transfertat ndaj te treteve (zeri 604)	73,000,000
Fondi per Investimet e Trupezuara (zeri 231)	2,000,000
TOTAL	94,792,000

Nderkohe, duhet permendur se duke u nisur nga nevojat e AMSHC- se per fonde te tilla si : Per shperndarje ne kuader te Thirrjeve per Projekte si dhe ne kuader te nevojtes specifike per perdorim te llogarise nr.606, ne Buxhetin e vitit 2012 jane bere disa ndryshime te miratuara nga Ministria e Financave me procedura ligjore, si me poshte behet e ditur:

Tabela e Ndryshimeve ne rishperndarjen e zerave Buxhetore

1- Shtim fondi ne Llogarine e Fondit per Transferta Familjare dhe Individet (zeri 606) ne vleren 60,000 leke
2- Transferte nga Fondi per shpenzime ne zerin Mallra dhe Sherbime (zeri 602) te nje vlere prej 3,000,000 lekesh ne Fondin Per Transferime Korrente te Brendshme (zeri 604)
3- Transferte fondi nga Llogaria e Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600) ne Fondin Per Transferime Korrente te Brendshme (zeri 604) ne vleren prej 900,000 lekesh.

Sipas ndryshimeve te lart permendura, rishperndarja aktuale e zerave Buxhetore te Buxhetit te Vitit 2012 eshte si me poshte vijon:

Fondi I Pagave (zeri 600)	10,189,000
Fondi I Sigurimeve Shoqerore (zeri 601)	1,703,000
Fondi per shpenzimet operative (zeri 602)	4,000,000
Fondi per transfertat ndaj te treteve (zeri 604)	76,900,000
Fondi per Investimet e Trupezuara (zeri 231)	2,000,000
Fondi per Transferta Per Buxhetet Familjare dhe Individet (zeri 606)	60,000
TOTAL	94,852,000

- **Nga fondi i pergjithshem buxhetor**, per periudhen e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore per **tremujorin e trete te vitit 2012** në **88,129,452 Leke** nga totali prej **94.852.000 Leke** nga fondi I planifikuar vjetor pra realizim prej **92.2%** te fondit te planifikuar vjetor.

- **Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore** (zeri 600-601), është realizuar në izbatim të strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe të VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”.
- Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht; **7,118,548 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi **69.8% dhe 1,216,619 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **71.4%**.
- **Fondi për shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime** (zeri 602), për vitin 2012, nga 4,000,000 të miratuara sipas Buxhetit të këtij viti duke shtuar edhe ndryshimet e lart përmendura sipas tabelës së ndryshimeve në rishpërndarjen e zerave, është shpenzuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 në vlerën **3,249,515 leke** pra realizim prej **81.2%**.
- Duhet përmendur se në realizimin e shpenzimeve operative, pra zeri 602, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje racionale të të kërkesave që lidhen kryesisht me realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit si tatumë , taksa energji elektrike, ujë, shërbime postare në funksion të gjitha këto të një ecurie normale të veprimtarisë në këtë institucion. Gjithashtu blerjen e të gjitha artikujve të kancelarisë, riparime automjeti e të tjera si dhe kryerjen e pagesave për likuidimin e furnitoreve dhe të tretë, të mbartura nga viti 2011.
- **Fondi në zerin për Transferime Korrente të Brendshme** (zeri 604), për vitin 2012 është në vlerën **76,900,000 leke** sipas ndryshimeve të zera të lartpërmendur.
- Nga ky zë për tremujorin e tretë të vitit 2012 janë realizuar shpenzime në vlerën **75,226,800 leke** pra realizimi i tre mujorit të fundit është në vlerën **97.8%** për këtë periudhë.

- Në realizimin e këtij zeri, AMSHC ka vazhduar me disbursimet për këstin e parë dhe të dytë (50% dhe 40%) e thirrjes së tretë dhe me keqet e mbetura të Granteve të miratuara dhe të kontraktuara të thirrjeve të mëparshme për OJF.
- **Fondi për shpenzim investime** (zeri 231) , është realizuar për tre muhorin e fundit të vitit 2012 në vlerën **1,257,970 leke** pra realizimi **62.8%** nga fondi prej **2,000,000** lekesh që është akorduar sipas buxhetit të vitit 2012 për këtë zë.

Edhe për Tremujorin e tretë të Vitit 2012, AMSHC ka zbatuar me korrektesë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile", si dhe legjislativën administrative-financiare shqiptare.

Drejtor Ekzekutiv I AMSHC

Rudi Bobrati

Konceptoi: L.Hasa
